

Nr. 2505/041 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 05/05/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: **DENONCIM Nr. 27** – Lidhur me mos publikimin e kontakteve në faqet zyrtare të internetit të Drejtuesve të Këshillit të Ministrave, 10 Ministrive të linjës, si dhe të 172 Institucioneve të varësisë, në funksion të Denoncimeve mbi çdo rast shpërdorimi të burimeve publike të Institucionit apo përfshirjes së nëpunësve në veprimtari politike ose elektorale në mbështetje të subjekteve zgjedhore apo kandidatëve.

I nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

Vendim nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator (KRR) “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve, i ndryshuar” është një akt me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve i cili përcakton një sërë rregullash për zgjedhjet, bazuar në detyrimet që përcakton Neni 91 dhe 92 i Kodit Zgjedhor.

Në tërësinë e rregullimeve të tij, që synojnë parandalim e keqpërdorimit të burimeve publike dhe funksionit e veprimtarisë shtetërore në favor të subjekteve zgjedhore apo kandidatëve të tyre, **Vendimi 9 parashikon**, ndër të tjera, **detyrimin për marrjen e një sërë masash parandaluese dhe monitoruese**, të cilat **ia ngarkon për zbatim drejtuesve** të institucioneve publike.

Kodi Zgjedhor dhe i gjithë Vendimi nr. 9 ndërton një mekanizëm me një parashikim gati të plotë të detyrave, të drejtave dhe ndalimeve, të cilat, në një qasje organike, **detyrojnë sjelljen që duhen të kenë tërë Institucionet Publike dhe veçanërisht Drejtuesit e tyre**, në zbatim të parimeve Kushtetuese e detyrimeve Ligjore, duke përcaktuar gati plotësisht **ndarjen e sjelljes institucionale shtetërore të institucioneve publike e punonjësve të tyre, nga e drejta e tyre private e personale për të shprehur liritë dhe të drejtat e tyre politike**, brenda kufizimeve që kuadri ligjor parashikon për ta.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në Kreun IV të Vendimit, “Përdorimi i burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para dhe gjatë fushatës zgjedhore” **përcaktohen më konkretisht** këto të drejta e detyrime, e sidomos **masat që duhen marrë nga** “Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë” (neni 7 i Vendimit).

Ndër masat parandaluese dhe monitoruese të parashikuara nga ligji, **një vend me shumë rëndësi zë publikimi i të dhënave të kontaktit të Drejtuesve të Institucionit**, në faqen zyrtare përkatëse të internetit, **me qëllim administrimin e çdo denoncimi dhe të çdo rasti të përfshirjes, nxitjes, urdhërimit, shantazhimit apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve** të atij institucioni në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor apo të kandidati në zgjedhje (neni 7, pika 1, gërma “c” e Vendimit).

E thënë ndryshe, ligji parashikon publikimin e të dhënave të Drejtuesve në faqen e internetit të çdo Institucioni, në **një rubrikë të posaçme e cila përshkruan qëllimin për të denoncuar direkt tek Drejtuesi i Institucionit çdo informacion apo të dhënë**, që mund të vijë nga vetë punonjësit në mënyrë anonime, nga çdo qytetar apo aktor i tretë, lidhur me **përdorimin e burimeve publike të atij institucioni në zgjedhje**, si dhe **mbi çdo rast të përfshirjes së punonjësit të atij Institucioni në veprimtari politike apo elektorale, apo lidhur me çdo nxitje, shantazh, urdhër apo kërkesë që mund t’i jetë bërë punonjësit** qoftë nga eprorët e tyre, qoftë nga të tretë.

Ky publikimin në faqen e internetit, madje në ndërfaqen kryesore të saj, është jo vetëm një detyrim që parashikon ligji, por edhe **përbën një tregues të qartë mbi vullnetin e Drejtuesve të Institucionit**, qoftë ky Politik apo i hierarkisë Institucionale, se Ata si Drejtues dhe tërë Institucioni do të zbatojnë me përpikmëri Ligjin **duke marrë angazhimet që iu kërkon Ligji për vënien përpara përgjegjësisë ligjore dhe ndjekjen e çdo rasti denoncimi që do t’iu paraqitet**.

Sipas Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator **Drejtuesit e institucioneve publike ishin të detyruar** të publikonin kontaktet e tyre në faqet zyrtare të internetit, për të mundësuar administrimin e denoncimeve dhe rasteve të përfshirjes së punonjësve në veprimtari politike apo mbështetje zgjedhore, që **prej datës 11 janar 2025**, datë në të cilën nisi periudha katër mujore përpara Zgjedhjeve të 11 Majit 2025, gjatë së cilës Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9 i KRR përcaktojnë detyrime për institucionet shtetërore me synim parandalimin e përdorimit të burimeve publike për avantazh elektorale.

Sipas vëzhgimit të kryer nga KRIIK **në faqet zyrtare të internetit të Kryeministrit dhe 11 Ministrive** të linjës, përjashtoj Ministrat e Shtetit, rezulton se vetëm një Ministri, **Ministria e Drejtësisë, ka publikuar të dhënat e kontaktit për denoncime**, siç kërkohej nga ligji .

Ndërsa dhjetë Ministrinë e tjera nuk e kanë zbatuar fare këtë detyrim, duke u vendosur kështu në shkelje të ligjit.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhur me **Institucionet e Varësisë të 11 Ministrive**, duke iu referuar listës së tyre të publikuar në faqen e internetit të çdo Ministrie, rezulton se nga totali prej **176 institucione varësie** vetëm **katër i kanë publikuar në faqen zyrtare** në internet të dhënat e kontaktit për Denoncime.

Katër Institucionet që i kanë publikuar konform Ligjit janë: [Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor](#); [Agjencia e Trajtimin të Pronave](#); [Autoriteti i Aviacionit Civil](#) dhe [Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor](#).

Ndërkohë 20 Institucione Varësie figurojnë që nuk kanë faqe zyrtare në internet, ndërsa për shtatë Institucione të tjera faqja e internetit nuk është funksionale, çka i vendos këto 27 Institucione në shkelje edhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782 datë 28.12.2024 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike”. (Pika 1 e Vendimit: “Çdo autoritet publik është i detyruar të ketë një faqe zyrtare të internetit për të ofruar informacione për autoritetin publik dhe për shërbimet, të cilat i ofron për shtetasit e personat fizikë dhe/ose juridikë, duke zbatuar rregullat e mëposhtme: ...”).

Konkretisht, Faqet Zyrtare të Këshillit të Ministrave, 10 Ministrive dhe 172 Institucioneve të tyre të Varësisë paraqiten më poshtë:

1. KËSHILLI I MINISTRAVE

1. [Agjencia për Media dhe Informim](#)
2. [Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian](#)
3. [Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore](#)
4. [Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara](#) (faqja e internetit nuk punon)
5. [Agjencia e Prokurimit Publik](#)
6. [Agjencia e Zhvillimit të Territorit](#)
7. [Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës](#) (nuk ka faqe interneti)
8. [Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit](#)
9. [Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje](#)
10. [Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile](#)
11. [Agjencia Shtetërore e Kadastrës](#)
12. [Agjencia Telegrafike Shqiptare](#)
13. [Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike](#)
14. [Avokatura e Shtetit](#)
15. [Departamenti i Administratës Publike](#)
16. [Drejtoria Përgjithshme e Arkivave](#) (faqja e internetit nuk punon)
17. [Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare](#)
18. [Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar](#)

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

19. [Inspektorati Qendror \(faqja e internetit nuk punon\)](#)
20. **Komiteti Shtetëror i Minoriteteve (nuk ka faqe interneti)**
21. [Komiteti Shtetëror i Kulteve](#)
22. [Shkolla Shqiptare e Administratës Publike](#)
23. [Shërbimi Informativ i Shtetit Shqiptar](#)
24. [Akademia e Shkencave](#)

2. [**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**](#)

1. [Agjencia Kombëtare të Burimeve Natyrore](#)
2. [Shërbimi Gjeologjik Shqiptar](#)
3. [Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse \(EITI\)](#)
4. [Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial](#)
5. [Agjencia Kombëtare Bërthamore](#)
6. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (nuk ka faqe interneti)
7. [Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit](#)
8. [Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit](#)
9. [Agjencia për Eficencën e Energjisë](#)
10. Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve (nuk ka faqe interneti)
11. [Autoriteti Rugor Shqiptar](#)
12. [Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil](#)
13. [Drejtoria e Përgjithshme Detare](#)
14. [Instituti i Transportit](#)
15. [Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve](#)
16. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore (nuk ka faqe interneti)
17. Autoriteti Rregullator Hekurudhor (nuk ka faqe interneti)
18. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare (nuk ka faqe interneti)
19. [Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para](#)
20. [Albgaz](#)
21. [Albpetrol](#)
22. [Operatori i Sistemit të Transmetimit](#)
23. [Korporata Elektroenergjitike Shqiptare](#)
24. [Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike](#)

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

3. [**MINISTRIA E DREJTËSISË**](#) (e ka publikuar)

1. [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve](#)
2. [Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit](#)
3. [Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës](#)
4. [Agjencia Kombëtare e Falimentit](#)
5. [Qendra e Botimeve Zyrtare](#)
6. [Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas](#)
7. [Instituti i Mjekësisë Ligjore](#)
8. [Komiteti Shqiptar i Birësimeve](#)
9. [Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve](#)
10. [Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve](#)

4. [**MINISTRIA E ARSIMIT SHE SPORTIT**](#)

1. [Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar](#)
2. [Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë](#)
3. [Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës](#)
4. [Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier](#)
5. [Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë](#)
6. [Qendra e Shërbimeve Arsimore](#)
7. [Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë](#)
8. [Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit](#)
9. [Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar](#)
10. [Agjencia e Shërbimit të Sporteve](#)
11. [Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë](#)
12. [Qendra e Botimeve për Diasporën](#)
13. [Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve të Rrjetit Telematik](#)
14. [Instituti i nxënësve që nuk shikojnë](#)
15. Instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë (nuk ka faqe interneti)

5. [**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**](#)

1. [Agjencia Kombëtare e Mjedisit](#)
2. [Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura](#)
3. [Agjencia Kombëtare e Turizmit](#)
4. [Agjencia Kombëtare e Bregdetit](#)
5. [Agjencia Kombëtare e Pyjeve](#)
6. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (nuk ka faqe interneti)

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

6. MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

1. [Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për Arbëreshët](#)
2. [Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik](#)
3. [Agjencia Kombëtare e Diasporës](#)

7. MINISTRIA E MBROJTJES

1. [Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes](#)
2. [Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile](#)
3. [Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura](#)
4. [Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve](#)
5. [Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit](#)
6. [Drejtoria e Shifrës](#)
7. [Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake](#)
8. [Njësia Mjekësore Ushtarake Përfaqësitë Ushtarake Jashtë Vendlindjes](#)
9. [Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit](#)
10. [Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut të Forcave të Armatosura](#)
11. [Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare](#)
12. [Rrota Bregdetare](#)

8. MINISTRIA E BRENDSHME

1. [Policia e Shtetit](#)
2. [Garda e Republikës](#)
3. [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
4. [Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit](#)
5. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (nuk ka faqe interneti)
6. [IdentiTek](#)
7. [Illyrian Guard](#)
8. [Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm](#)

9. MINISTRIA E FINANCAVE**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1. [Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve](#)
2. [Drejtoria e Përgjithshme e Doganave](#)
3. [Qendra e Trajnimit të Administrës Tatimore dhe Doganore](#)
4. [Agjencia e Inteligjencës Financiare](#)
5. [Autoriteti i Mbikëqyrës së Lojërave të Fatit](#)
6. [Agjencia e Trajtimit të Kredive](#)
7. [Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë](#)
8. Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë (nuk ka faqe interneti)

10. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

1. [Autoriteti Kombëtar i Ushqimit](#)
2. [Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural – AZHBR](#)
3. [Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare – ISUV](#)
4. [Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve](#)
5. [Enti Shtetëror i Farave dhe Fidaneve](#)
6. [Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve](#)

11. MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

1. [Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor](#)
2. [Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore](#)
3. [Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve](#)
4. Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë (nuk ka faqe interneti)
5. [Instituti i Shëndetit Publik](#)
6. [Instituti i Integritetit për Ish të Përndjekurit](#)
7. [Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor](#)
8. [Klinika Stomatologjike Universitare](#) (faqja nuk punon)
9. [Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut](#)
10. [Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore](#)
11. [Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore](#) (faqja nuk punon)
12. [Qendra Kombëtare e Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore](#) (faqja nuk punon)
13. [Qendra Kombëtare Edukimit në Vazhdim](#) (faqja nuk punon)
14. [Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët](#)

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

15. [Shërbimi Social Shtetëror](#)

12. [MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT](#)

1. [Teatri Kombëtar i Operas, Baletit](#)
2. [Biblioteka Kombetare e Shqipërisë](#)
3. Teatri Kombëtar (nuk ka faqe interneti)
4. Teatri Kombëtar Eksperimental Kujtim Spahivogli (nuk ka faqe interneti)
5. Galeria Kombëtare e Arteve (nuk ka faqe interneti)
6. Cirku Kombëtar (nuk ka faqe interneti)
7. [Muzeu Historik Kombëtar](#)
8. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë
9. [Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”](#)
10. [Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”](#)
11. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlorë (nuk ka faqe interneti)
12. [Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore](#)
13. [Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore](#)
14. [Qendra Kombëtare e Kulturës për fëmijë, Teatri i kukullave](#)
15. [Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit](#)
16. Qendra Muzeore Durrës (nuk ka faqe interneti)
17. Qendra Muzeore Krujë (nuk ka faqe interneti)
18. [Qendra Muzeore Berat](#)
19. [Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale](#)
20. [Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Berat](#)
21. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë (nuk ka faqe interneti)
22. [Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër](#)
23. [Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë](#)
24. [Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë](#)
25. [Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë](#)
26. [Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit](#)
27. [Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis](#)
28. [Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Butrint](#)
29. [Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale](#)
30. [Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve \(AIDA\)](#)
31. [Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive](#)
32. [Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut \(ISHMT\)](#)
33. [Instituti i Sigurimeve Shoqërore \(ISSH\)](#)
34. [Qendra Kombëtare e Biznesit](#)

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

35. [Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit](#)
36. [Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore](#)
37. [Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit](#)
38. [Enti Kombëtar i Banesave](#)
39. [Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve](#)
40. [Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë](#)
41. [Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës](#)

Për shkak të volumit të madh, në këtë [LINK](#) paraqiten paraqiten printscreen-et e faqeve të internetit për secilën nga Institucionet e paraqitura më sipër, **të cilat konstatohen në shkelje të ligjit.**

Kjo papërgjegjshmëri masive në mos zbatimin e ligjit, përbën një sfidë që këta Drejtues Institucionesh i bëjnë Ligjit, duke shprehur qartazi vullnetin e tyre dhe penguar qytetarët dhe punonjësit e administratës publike që të shfrytëzojnë të drejtat që iu jep Ligji, për të denoncuar raste të mundshme të përfshirjes së burimeve të Institucionit në veprimtari politike apo mbështetje zgjedhore, duke cënuar llogaridhënien dhe integritetin institucional.

Referuar sa më sipër, **KRIIK i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që:**

- Të ndërhyjë në mënyrë urgjente për të detyruar Institucionet shtetërore të zbatojnë detyrimet ligjore, konkretisht parashikimet e Nenit 7, pika 1/c të Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020.

Madje t'i udhëzojë Institucionet që dritarja e dedikuar për denoncime apo lidhja përkatëse të jetë në një vend të dukshëm të faqes së internetit, në mënyrë që të jetë lehtësisht e dallueshme për përdoruesit;

- të aplikojë sanksione administrative ndaj të gjithë Drejtuesve të Institucioneve të renditur më sipër sipas parashikimeve të nenit 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania